



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS, AMBASADORIT FLORIAN RAUNIG,
NË KONFERENCËN RAJONALE TË GRAVE PARLAMENTARE**

Tirana, 27 April 2016

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Jam i lumtur që shoh këtu një grup të madh deputetesh nga mbarë rajoni i Ballkanit, si dhe nga Turqia.

Ne, në OSBE, besojmë fuqimisht në rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në jetën publike dhe politike. Ky është një parakusht për zhvillimin demokratik dhe ekonomik. Përfaqësimi në masë të madhe i grave në vendimmarrje është i një rëndësie thelbësore për çdo vend që aspiron të realizojë potencialin e vet të plotë.

Gjatë viteve të shkuara, është bërë përparim në pjesëmarrjen e grave në politikë. Aktualisht, rreth 26% e deputetëve në parlamentet e zonës së OSBE-së janë gra. Megjithatë kjo gjë shënon një përparim, pasi në vitin 1995 ato përbënin vetëm 13% të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ende jemi larg realizimit të synimit të barazisë gjinore.

Prezenca e OSBE-së e ka promovuar prej kohësh barazinë gjinore dhe ka punuar për të fuqizuar gratë që të marrin pjesë plotësisht në jetën publike dhe politike të vendit. Janë shënuar suksese të rëndësishme. Sot që po flasim, tetë prej 21 anëtarëve të qeverisë shqiptare dhe 32 prej 140 deputetëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë janë gra. Në vitin 2013, u ringrit me sukses Aleanca e Grave Deputete, me ndihmën e Prezencës së OSBE-së. Aleanca është një model i aksionit ndërpartiak që përkushtohet për t'i fuqizuar gratë politikisht dhe ekonomikisht. Anëtarët e Aleancës kanë vërtetuar se gratë jo vetëm që mund të luajnë vetë rolin e tyre si politikane, por gjithashtu që ato mund të jenë udhëheqëse të efektshme dhe të respektuara prej të gjithëve, e të ngrenë ura mbi ndasitë politike.

Ndoshta të frymëzuara nga këta shembuj, gjithnjë e më shumë gra në Shqipëri po interesohen për politikën dhe po dalin si kandidate. Futja e kuotës gjinore prej 50% për këshillat bashkiakë, në zgjedhjet vendore të qershorit 2015, që u mbështet fuqimisht nga Prezenca e OSBE-së, shënoi një hap të madh përpara dhe ndihmoi në nivelimin e fushës së lojës për gratë kandidate. Pas zgjedhjeve të 2015-s, Shqipëria ka mbi 550 gra në këshillat bashkiakë ose 34%. Kjo është një rritje e dukshme krahasuar me zgjedhjet vendore të 2011-s, ku gratë përbënin vetëm 12 për qind të këshillave bashkiakë.

Shumë prej këtyre këshilltareve u trajnuan nga një rrjet kombëtar i grave, i ngritur më 2010 nga Prezenca e OSBE-së. Ne po punojmë me këto gra për të siguruar që ato të kenë aftësitë e duhura për të pasur sukses në postet e tyre të reja.

Ka pasur përparim domethënës në të tërë rajonin e OSBE-së, por ai ka qenë më i ngadaltë dhe më i panjëtrajtshëm nga ç'do të kishim dëshiruar. Jemi ende larg barazisë së plotë mes burrave dhe grave. Me gjithë përmirësimet e dukshme në aksesin në shëndetësi dhe arsim, si dhe rritjes së të drejtave ligjore, diskriminimi vazhdon të jetë i pranishëm në shumë vende,

dhe dhuna kundër grave dhe vajzave vazhdon. Të drejtat e grave nuk janë vetëm shqetësim i grave – ato duhet të përqafohen edhe nga udhëheqësit politikë. Asnjë vend nuk mund të presë të zhvillohet kur injoron problemet që prekin gjysmën e popullsisë dhe kontributet që mund të japë kjo pjesë.

Ju nxis të gjithave të shkëmbeni mendime dhe ide, të mësoni nga njëra-tjetra, të komunikoni dhe të bashkërendoni përpjekjet tuaja. Kështu, mund t'u shërbeni më mirë shoqërive tuaja dhe të jeni promotore të efektshme të ndryshimit. Së bashku, gratë e të gjitha partive dhe niveleve të qeverisjes mund të arrijnë shumë më tepër se sa po të punonit më vete apo të izoluara nga njëra-tjetra.

Duke shërbyer si shembuj të grave politikane të forta e të suksesshme në vendet që përfaqësoni, ju po frymëzoni dhe po nxitni gra të tjera që të garojnë si kandidatë dhe po fitoni besimin e zgjedhësve tuaj.

Ne, në OSBE, do të vijojmë të punojmë me ju në të gjitha nivelet – ndërkombëtar, kombëtar dhe vendor – për të promovuar pjesëmarrjen e plotë të grave në jetën politike dhe publike.